



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA
PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-016-01-0093334

Pejë, datë: 10 Dhjetor 2025.

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **Inauguruese e Kuvendit të Komunës Pejë**, e mbajtur me datë: 10. Dhjetor 2025, me fillim në ora 10:00

Mbledhja u mbajt në sallën e takimeve të Kuvendit të Komunës Pejë.

Në mbledhje prezantuan të gjithë 35 anëtarët e zgjedhur të Kuvendit.

Pos anëtarëve të zgjedhur të kuvendit sipas listes së çertifikuar nga KQZ të zgjedhjeve Lokale të 12 tetorit 2025, në mbledhje prezantuan: kryesusja e senacës znj.Drita Maloku, Kryetari i zgjedhur i Komunës z. Gazmend Muhaxheri, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit të Komunës së Pejës, znj.Donjeta Morina, zyrtare administrative, mysafiret e ftuar për këtë seancë inauguruese, prijësit e bashkësive fetare, përfaqësues të Policisë së Kosovës, të KFOR -it, OSBE - së, OJQ - ve, mjeteve të informimit publik, dhe qytetarët e interesuar.

Për nderë të kësaj seance inauguruese, përformojë me një pikë muzikore soprano znj.Adelina Paloja dhe piano znj.Alba Muçolli Dehiri.

Mbledhja inauguruese e Kuvendit është thirrur nga Kryetari i zgjedhur i Komunës z. Gazmend Muhaxheri, dhe është kryesuar nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës, znj.Drita Maloku, me këtë:

REND DITE

- 1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.**
- 2. Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës.**
- 3. Dhënja e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.**
- 4. Dhënja e betimit të Kryetarit të Komunës.**
- 5. Fjala përshendetëse e Kryetarit të Komunës.**
- 6. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës nga rradhet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Pejës.**

- 1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.**

Në mbledhje prezantojnë të gjithë 35 anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Pejës, të Çertifikuar me Vendim nga KQZ, të cilët njëkohësisht janë nënshkruar në listën e nënshkrimeve të anëtarëve prezent.

- 2. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës.**

Kryesuesja seancës znj. Dritë Maloku, filimisht përshendeti kryetarin e rizgjedhur të Komunës për të katër-ten herë z. Gazmend Muhaxheri, këshilltarët komunal, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, Policisë së Kosovës, përfaqësuesit fetarë, përfaqësuesit e mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare dhe qytetarët e ndëruar të Komunës së Pejës.

Kryesuesja seancës znj. Dritë Maloku, konstatoi se: janë përmbushur kushtet ligjore për mbajtjen e kësaj mbledhje inauguruese, se çertifikimi i mandatave për anëtar të kuvendit dhe kryetar komune është bërë nga KQZ -ja, si dhe se ekziston kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhje, nga se në mbledhje prezantojnë të gjithë 35 anëtarët e zgjedhur të kuvendit komunal Pejë, të cilët pjesëmarrjen e tyre e konfirmojnë me nënshkrim në listën e nënshkrimeve të anëtarëve prezent.

Kryesuesja pastaj ftoi anëtarët e kuvendit komunal për dhënjen e betimit .

- 3. Dhënja e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.**

Anëtarët e Kuvendit të Komunës dhanë betimin dhe nënshkruan deklaratën solemne.

Pas përfundimit të procesit të votimit, përfaqësuesi i Komisionit për mbarrvajtjen e procesit të votimit z. Naser Gega, hapi kutin e votimit dhe në prezencë të anëtarëve të kuvendit dhe mediave elektronike dhe të shkruara, numroi një për një fletëvotimet që ishin në kuti. Pastaj, komunikoi rezultatet e votimit:

- se në votim morën pjesë 28 anëtarë të Kuvendit të Komunës, ndërsa 7 anëtar ishin prezent mirpo nuk morën pjesë në votim.

Në fund komisioni për mbarrvajtjen e procesit të votimit, konstatoi se në votimin e parë:

- kandidati për kryesues të Kuvendit të Komunës z. Rexhep Kurtbogaj, ka marr **20 (njetzet) vota pro, 8 votë abstenim, të anëtarëve prezentë të kuvendit të komunës dhe që votuan për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, që është më shumë se gjysma e votave të numrit të përgjithshëm të zgjedhur të kuvendit të komunës (të bashkëngjitur e gjeni procesverbalin e komisionit).**

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: falenderoi anëtarët e kuvendit dhe ju uroj për mandatin e ri që jeni zgjedh, një falemnderim për kryetarin, mediat dhe të pranishmit; të nderuar anëtar ju falemnderoj për besimin që ma dhatë prap si kryesues, do të jem i përkushtuar dhe shpresoj që të jemi konstruktiv, duke u bazuar në rregulloret dhe legjislacionin në fuqi do të punojmë për qytetin e Pejës dhe mirqenien e qytetarëve.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: për zgjedhjen e organeve tjera do të ju njoftojmë me kohë për seancën e radhës.


Video incizimi i takimi të seancës inauguruese të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=EZv4CsdhZGo>

Me që, u përfunduan të gjitha pikat e rendit të ditës, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, falenderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe përkrahje dhe në fund e shpalli të mbyllur mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Pejës.

Mbledhja u mbyll në ora 12:25.

Procesmbajtësja,
Znj. Donjeta Morina



KRYESUESJA MBLEDHJES,
znj. Dritë MALOKU

